
BULETIN INFORMATIV

Dhjetor 2024

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Dhjetor, 2024

Përmbajtje

Zgjedhje në kryesinë e ASHSH	5
Zhvillohen zgjedhjet për tre anëtarët e Kryesisë së Akademisë së Shkencave	6
Aktivitete	9
Sot nisi takimi treditör i redaksive vendore të Tiranës e Prishtinës për përmbylljen e punës për finalizimin e fjalësit të “Enciklopedisë shqiptare”	10
U zhvillua dita e dytë e takimit të redaksive vendore të Tiranës e Prishtinës për përmbylljen e punës për finalizimin e fjalësit të “Enciklopedisë shqiptare”	12
Mbyllen punimet treditore të redaksive vendore Shqipëri-Kosovë për projektin madhor "Enciklopedia shqiptare"	14
U zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare “Teknologjia, Inteligjenca Artificiale (IA) dhe Transformimi i Kërkimit Shkencor”	17
U zhvillua konferenca e parë shkencore ndërkombëtare në Shqipëri mbi artin në hapësirën publike dhe transformimin e qytetit me temë “Qyteti i shpalosur: arti si faktor shndërrimesh”	21
U zhvillua në Prishtinë seminari vjetor NanoAlb/ NanoBALKAN-NanoALB Workshop 2024 dhe Forumi Kuarç	25
Në Akademinë e Shkencave u mbajt një koncert me veprat e kompozitorëve më të njohur mbarëshqiptarë	29
U mbajt veprimtaria “Kujtojmë prof. Agron Ficon” me rastin e 90-vjetorit të lindjes. 31	
U zhvillua konferenca shkencore përkujtimore “Poliedriciteti i prof. Jup Kastratit dhe mbarëkombëtarë në studimet e tij”	35
U zhvillua konferenca shkencore “E kaluara në të tashme” - Ruajtja, digjitalizimi dhe rëndësia e fondeve etnografike dhe arkivave të trashëgimisë kulturore në bashkëkohësi	39
U zhvillua konferenca e parë shkencore “Mjedisi urban - binomi: ndërtim - gjelbërim urban”	42
Promovime	44
60-vjetori: Promovohet numri i fundit i revistës shkencore “Studia albanica”, botim i Akademisë së Shkencave	45

Një paraqitje e arritjeve të revistës “Studime historike” me rastin e 60-vjetorit të saj.	48
Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë paraqiti numrin special “Studime filologjike, Bibliografi 1964-2024, me rastin e 60-vjetorit	53
U promovua libri “Ikonostaset e Shqipërisë” me bashkautorë Andrea Llukani - Ylli Drishti.....	58
U promovua libri “Bujqësia biologjike”, një material me shumë rëndësi në formimin e specialistëve të bujqësisë, me autor Enver Isufin	60
Marrëveshje bashkëpunimi	63
Marrëveshje bashkëpunimi midis Akademisë së Shkencave dhe Bashkisë Roskovec	64
Mbledhje të komisioneve të përhershme të ASHSH.....	65
U zhvillua mbledhja e Komisionit të përhershëm të Gjuhësisë dhe të Letërsisë për projektin e strategjisë së kërkimit shkencor dhe planifikimin e aktiviteteve për vitin 2025	66
U zhvillua mbledhja e Komisionit të arteve	67
U zhvillua mbledhja e Komisionit të përhershëm të historisë	69
U zhvillua mbledhja e Komisionit të përhershëm të ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike	72
Takime pune	74
Takim pune për bashkëpunimin me kryetarët e bashkive të rretheve dhe drejtuesit e punonjësit e bibliotekave publike të përfshira në rrjetin COBISS.AL	75

Zgjedhje në kryesinë e ASHSH

Zhvillohen zgjedhjet për tre anëtarët e Kryesisë së Akademisë së Shkencave

- Akad. Anila Hoda zgjidhet sekretare shkencore e Akademisë së Shkencave, akad. Neki Frashëri rizgjidhet kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike dhe akad. asoc. Gëzim Hoxha rizgjidhet kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike



Sot, më 10 dhjetor 2024, u mbledh Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe zhvilloi zgjedhjet për tre anëtarët e Kryesisë: të sekretarit shkencor, kryetarit të Seksionit të Shkencave Natyrore Teknike dhe të kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike.

Akad. Anila Hoda u zgjodh sekretare shkencore e Akademisë së Shkencave.

Akad. Neki Frashëri u rizgjodh kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike.


Akad. asoc. Gëzim Hoxha u rizgjodh kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike.

Votuan 48 anëtarë të Asamblesë, nga 53 anëtarë gjithsej.

Dy prej votave të dërguara me postë nuk mbërritën dhe tre anëtarë nuk morën pjesë në votim.

Akad. Anila Hoda, e cila kandidoi për pozicionin e sekretarit shkencor, mori 47

vota pro dhe 1 votë kundër.



Akad. Neki Frashëri, i cili kandidoi për pozicionin e kryetarit të SSHNT, mori 43 vota pro, 3 vota kundër dhe 2 abstenim.



Për pozicionin e kryetarit të SSHSHA, garuan dy kandidatë:

Akad. asoc. Gëzim Hoxha mori 38 vota pro, akad. Albert Doja mori 8 vota dhe 2 vota ishin të pavlefshme.



www.akad.gov.al

Aktivtete

Sot nisi takimi treditor i redaksive vendore të Tiranës e Prishtinës për përmbylljen e punës për finalizimin e fjalësit të “Enciklopedisë shqiptare”



Sot më 19 dhjetor 2024, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, nisi punimet takimi i përbashkët i redaksive vendore të Tiranës dhe Prishtinës të Enciklopedisë shqiptare. Takimi do të vijojë nga 19-21 dhjetor 2024.

Ishin të pranishëm akad. Mehmet Kraja, Kryetar i ASHAK; akad. Vasil S. Tole, zëvendëskryetar i ASHSH; dr. Arian Leka, drejtues i Qendrës së Botimeve Enciklopedike e Albanologjike; akad. Beqir Meta, akad. Fehmi Rexhepi, akad. Adem Bunguri, prof.dr. Frashër Demaj, prof.dr. Muhamet Mala, prof.dr. Jusuf Bajraktari, akad. Gëzim Hoxha, prof.dr. Arianit Buqnica, akad. Pëllumb Xhufi (online) dhe prof.dr. Ferid Duka.

Në këtë takim ishin të pranishëm edhe Lendita Pula, sekretare e redaksisë vendore, Kosovë; Drisela Diamanti, koordinatore QBAE-së; Enkelejda Misha, koordinatore e QBAE-së.

Kjo veprimtari mbahet për përmbylljen e punës për finalizimin e fjalësit të projektit madhor “Enciklopedia shqiptare”.

Takimi u drejtua nga zëvendëskryeredaktori i Enciklopedisë shqiptare akad. Mehmet Kraja dhe dr. Arian Leka.



Qëllimi i këtij takimi ishte që redaksitë e grupfushës: Historia e shekullit XX; Historia e mesjetës e Bizanti, Periudha osmane dhe Rilindja; Arkeologjia dhe lashtësia; të diskutojnë dhe vendosin për njësitë enciklopedike të pikëtakimit të objektit të tyre.

www.akad.gov.al

U zhvillua dita e dytë e takimit të redaksive vendore të Tiranës e Prishtinës për përmbylljen e punës për finalizimin e fjalësit të “Enciklopedisë shqiptare”



Sot më 20 dhjetor 2024, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, u zhvillua dita e dytë e takimit të përbashkët të redaksive vendore të Tiranës dhe Prishtinës të Enciklopedisë shqiptare.

Ishin të pranishëm redaktorë përgjegjës të redaksive të fushave: artet skenike pamore dhe multimediale; trashëgimia kulturore; ngulimet historike dhe diaspora, si akad. Mehmet Kraja, Kryetar i ASHAK-ut; akad. Vasil S. Tole, zëvendëskryetar i ASHSH-së; dr. Arian Leka, drejtues i Qendrës së Botimeve Enciklopedike e Albanologjike; prof.dr. Zana Shuteriqi, prof.dr. Eqrem Basha, prof. dr. Besim Rexhaj, prof. dr. Irakli Koçollari, Kosovar Basha, prof.asoc. Ferhit Hudhri, Suzana Varvarica Kuka, Ben Andoni, dr.Tahir Latifi, Suzana Jakupi. Ishin të pranishme, gjithashtu, Lendita Pula, sekretare e redaksisë vendore, Kosovë; Dafina Kavaja, koordinatore, Kosovë; Drisela Diamanti, koordinatore QBAE; Enkelejda Misha, koordinatore QBAE.

Takimi u drejtua nga zëvendëskryeredaktori i Enciklopedisë Shqiptare akad. Mehmet Kraja dhe dr.Arian Leka dhe akad. Vasil Tole.



Ky takim, që bëhet në përmblyllje të punës për finalizimin e fjalësit të projektit madhor “Enciklopedia shqiptare” do të mbyllet nesër më 21 dhjetor 2024.

Për hartimin e “Enciklopedisë shqiptare” janë të angazhuara 27 redaksi të fushave në Tiranë, 29 redaksi të fushave në Prishtinë dhe një redaksi e posaçme për Maqedoninë e Veriut.

www.akad.gov.al

Mbyllen punimet treditore të redaksive vendore Shqipëri-Kosovë për projektin madhor "Enciklopedia shqiptare"

- Përmbyllja e fazës për hartimin e fjalësit ishte fokusi i këtyre takimeve me redaksitë e 8 grupeve të fushave, sipas kalendarit të përbashkët-



Në datat 19, 20 dhe 21 dhjetor 2024, sipas parashikimit të shkresës nr. 1748 prot. datë 16.12.2024, Qendra e Botimeve Enciklopedike Albanologjike (QBEA), në bashkëpunim me redaksitë vendore Tiranë-Prishtinë, organizoi takimet e dakordësuara mes drejtuesve të redaksive vendore gjegjëse dhe redaktorëve përgjegjës të disa redaksive.

Takimet u mbajtën në mjediset e Akademisë së Shkencave, salla "Akademikët". Këto takime ishin pjesë e fazës përmbyllëse për finalizimin e punës me Fjalësin e bashkuar.

Në këto takime morën pjesë 32 përfaqësues të redaksive vendore, drejtuesit e redaksive dhe, aty ku ishte e nevojshme, morën pjesë edhe disa prej anëtarëve të redaksive të fushave (redaksia Mesjeta, Bizanti, Periudha osmane dhe Rilindja; redaksia e Arteve Skenike, Pamore dhe Multimediale) apo anëtarë të redaksisë vendore (Lashtësia).

Raundi i parë i këtyre takimeve bëri bashkë për 3 ditë, 8 redaksi, të cilat kishin ende problematika dhe çështje për të dakordësuar mes tyre.

Takimet u drejtuan nga akad. Mehmet Kraja, njëherazi drejtues i redaksisë vendore Prishtinë, dhe zëvendëskryeredaktor i projektit Enciklopedia shqiptare, akad. Vasil Tole dhe dr. Arian Leka, drejtues i QBEA-së dhe anëtar i redaksisë vendore Tiranë.



Pjesëmarrës të tjerë ishin redaktorë përgjegjës të fushave nga Shqipëria dhe Kosova: akad. Beqir Meta, akad. Fehmi Rexhepi, akad. Adem Bunguri, prof.dr. Frashër Demaj, prof.dr. Muhamet Mala, prof.dr. Jusuf Bajraktari, akad. Gëzim Hoxha, prof.dr. Arianit Buqnica, akad. Pëllumb Xhufi (online), prof.dr. Ferid Duka, dr. Zana Shuteriqi, prof.dr. Eqrem Basha, prof. dr. Besim Rexhaj, prof. dr. Irakli Koçollari, dr.Tahir Latifi, Kosovar Basha, dr. Suzana Varvarica Kuka, Ben Andoni, Suzana Jakupi, prof. dr. Evalada Paci, prof. Nysret Krasniqi, Naim Zoto, Binak Kelmendi, si dhe znj. Lendita Pula - sekretare e redaksisë vendore, Kosovë, znj. Drisela Diamanti - koordinatorë QBAE-së, znj. Enkelejda Misha - koordinatorë e QBAE-së, znj. Dafina Kavaja, koordinatorë, Kosovë.

Në fund të këtyre takimeve u dhanë udhëzimet përkatëse që të gjitha redaksitë të plotësojnë me shënime sqaruese (anëshkrime) artikujt e propozuar, aty ku artikulli shfaqet jo i plotë, duke dhënë shpjegime mbi argumentin se çfarë përfaqëson artikulli i propozuar pse duhet të jetë artikull më vete apo përmbledhës në enciklopedi.

U dakordësua në parim që mes datave 8,9,10, 13, 14 janar 2025 të ketë edhe një raund tjetër takimesh për redaksitë e Gjuhësisë/Albanologji, Arsimimit, Sistemet politike, Historisë ushtarake, Ekonomisë, disa redaksi të shkencave natyrore dhe

shkencave ekzakte, përfshi këtu saktësimet përfundimtare re propozimet e ardhura nga redaksia e posaçme e Maqedonisë së Veriut, drejtuar nga prof. Aziz Pollozhani dhe prof. Valbona Toska.



U vendos që afati i dorëzimit të Fjalësit nga të gjitha redaksitë pjesëmarrëse në takimet e datave 19-21 dhjetor 2024, të jetë jo më vonë se 15 janari 2025. Versioni i Fjalësit të dorëzuar të jetë përfundimtar: i konverguar, i integruar dhe i njësuar.

Hartimi i “Enciklopedisë shqiptare” është një projekt i përbashkët i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, i mbështetur dhe bashkëfinancuar nga qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës. Ajo është konceptuar si një tërësi njësisish enciklopedike me rreth 300 artikuj të mëdhenj; 2000 artikuj të mesëm; 7000 artikuj të vegjël e rreth 600 artikuj përmbledhës.

www.akad.gov.al

U zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare “Teknologjia, Inteligjenca Artificiale (IA) dhe Transformimi i Kërkimit Shkencor”

Në datën 3 dhjetor 2024 u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare “Teknologjia, Inteligjenca Artificiale (IA) dhe Transformimi i Kërkimit Shkencor”, organizuar nga Akademia e të Rinjve në bashkëpunim me Njësinë e kërkim studimit për inteligjencën artificiale në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Në këtë konferencë morën pjesë 53 studiues të shquar, të cilët përfaqësonin 21 institucione kombëtare dhe ndërkombëtare nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi, Turqia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe India.



Seancën plenare e përshëndeti Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi, i cili theksoi rëndësinë e diskutimit shkencor në lidhje me ndikimin transformues të inteligjencës artificiale në kërkimin shkencor dhe mbështeti nismën e Akademisë së të Rinjve për të trajtuar çështje të teknologjisë dhe inteligjencës artificiale, që ndikojnë fuqishëm në veprimtarinë shkencore të kërkuesve të rinj.

E pranishme ishte edhe zëvendësministrja e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, prof. dr. Ana Kapaj, e cila mbajti një fjalë përshëndetëse. Ajo e vuri theksin në rëndësinë e komunikimit më të ngushtë mes MAS-it dhe institucioneve kërkimore, për të maksimalizuar potencialet mbështetëse për kërkimin shkencor përmes programeve dhe projekteve të ndryshme.

Më tej, bashkëpresidentët e Akademisë Globale së të Rinjve (GYA), dr. Chandra Shekhar Sharma dhe dr. Yensi Flores Bueso (online) u shprehën për mbështetjen e shkencëtarëve të rinj që të përfshihen në diskutimin dhe të shpërndajnë dijen e tyre në lidhje me përdorimin e IA-së në dobi të njerëzimit.

Akad. Prof. Neki Frashëri, Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike (ASHSH), drejtues i kësaj konference bëri një prezantim informativ dhe të thelluar për shkencën që qëndron pas IA-së, e cila bën të mundur të realizohen mjaft veprime mjaft komplekse dhe të shpejta. Ai tha se IA duhet të përfshihet gjithnjë e më shumë në projektet kërkimore, duke e njohur thellësisht funksionin dhe dobinë e saj.

Akad. asoc. Kozeta Sevrani drejtuese e konferencës prezantoi rastet e përdorimit të IA-së në kërkimin shkencor, por edhe në zbatimin praktik në dobi të përmirësimit të jetës së njeriut të kohëve të sotme. Gjithashtu, ajo përmendi disa konferenca dhe projekte të tjera paraprëse të zhvilluara në ASHSH, dhe jo vetëm për IA-në në Shqipëri, dhe tha se kjo konferencë përplotëson një kuadër më të gjerë, duke synuar adresime më specifike në lidhje me përdorimin e IA-së në kërkimin shkencor.



Më tej, z. Franc Zylyftari, ekspert në Sektorin e Reagimit ndaj Incidenteve të Sigurisë nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, shpjegoi rëndësinë e përdorimit të IA-së në çështjet e sigurisë.

Konferenca i zhvilloi punimet në tre sesione.

Në sesionin “IA në shkencat e natyrës” Gledjan Caka solli në vëmendje ndikimin e mutacioneve të gjenit HOXB13 në kancerin e prostatës. Marinela Meckaroska prezantoi modelimin kinetik të distilimit të vajrave esenciale nga lëkurat e mandarinave. Aulon Shabani diskutoi aplikimet e inteligjencës artificiale për përmirësimin e efikasitetit energjetik në ndërtesa. Klaudio Peqini ofroi një vështrim mbi ndikimin transformues të machine learning në fizikën moderne. Jonilda Llupa trajtoi çështjet e sigurisë ushqimore dhe menaxhimit të mbetjeve. Shefqet Meda prezantoi përdorimin e algoritmeve të

machine learning për pacientët diabetikë. Favia Abazi solli një sistem për detektimin e sëmundjeve të lëkurës. Ledia Vasjari diskutoi rëndësinë e algoritmeve kompjuterike në biologjinë molekulare. Oresta Saliaj ndau përvojën e përdorimit të aplikacioneve të navigimit për grumbullimin e të dhënave të gjeo-referencuara, lidhur me menaxhimin e biodiversitetit urban.

Në sesionin e dytë “Inteligjenca artificiale në edukim” Mürsel Doğrul mbajti një kumtesë për përpjekjet e akademisë turke të të rinjve (TÜBA) për të çuar përpara kërkimin shkencor dhe inovacionin e përgjegjshëm përmes projekteve strategjike. Jani Koçillari theksoi rëndësinë e përdorimit të IA-së në kërkimet historiko-arkologjike. Belfjore Zifla (Qose) shtjelloi në kumtesën e saj sfidat që lidhen me integrimin e inteligjencës artificiale në studimet letrare. Ksenaf Sam Akulli me prezantimin e tij e vuri theksin tek reformësimi i peizazhit global rreth edukimit dhe punësimit në epokën e inteligjencës artificiale. Shaniko Allajbeu nënvizoi rëndësinë e inovacionit në mësimdhënie si dhe rolin kyç të teknologjisë në përgatitjen e brezave të rinj për sfidat e tregut të punës. Leonora Hysolli foli për nevojën e analizës së ndryshimeve në praktikat e mësimdhënies dhe stimulimit të inovacionit në kërkim shkencor, për shkak të rritjes dhe zhvillimit të teknologjive të reja dhe ndikimit të inteligjencës artificiale. Flavio Poroçani mbajti një kumtesë për transformimin e arsimit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.



Në sesionin e tretë “AI në Shkencat Humane” folësja e parë, Zsafia Turoczy, prezantoi një iniciativë të re të ndërmarrë në sistemin parauniversitar në Austri për mësimdhënien e historisë shqiptare, duke përdorur inteligjencën artificiale. Redion Luli foli mbi nevojën e rregullimit ligjor në përdorimin e AI gjeneruese në industrinë kreative. Ardit Dervishi prezantoi punimin mbi teknologjinë MIMO në fushën e netëork-ut dhe telekomunikacionit. Resul Telhaj paraqiti punimin mbi zhvillimin e kërkimit shkencor

për gjuhën shqipe nën ndikimin e teknologjisë. Mayank Dutt Kaushik prezantoi një analizë gjithëpërfshirëse të ndikimit të AI në prodhimtarinë mediatike. Aida Zoto paraqiti studimin mbi përdorimin e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në mësimin e gjuhës greke. Prezantimi i fundit u mbajt nga Pranvera Beqiraj, e cila analizoi ndryshimet në praktikat e mësimdhënies dhe stimulimit të inovacionit në kërkim për shkak të teknologjive të reja dhe IA.

Çdo prezantim kontribuoi me qasje të veçanta dhe të dobishme në fushën përkatëse. Diskutimet ishin të pasura dhe ndihmuan për të hapur rrugë të reja bashkëpunimi shkencor. Diversiteti i temave dhe i përvojave që sollën pjesëmarrësit, ndihmoi në adresimin e sfidave të përbashkëta dhe në eksplorimin e mundësive që ofron kjo epokë transformuese.

U zhvillua konferenca e parë shkencore ndërkombëtare në Shqipëri mbi artin në hapësirën publike dhe transformimin e qytetit me temë “Qyteti i shpalosur: arti si faktor shndërrimesh”



Në datat 12 dhe 13 dhjetor 2024, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Qendra e Studimit të Arteve pranë kësaj akademie zhvilloi konferencën e parë shkencore ndërkombëtare në Shqipëri mbi artin në hapësirën publike dhe transformimin e qytetit me temë “Qyteti i shpalosur: arti si faktor shndërrimesh”.

Veprimtaria u zhvillua në praninë e kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi dhe të anëtarëve të tjerë të Kryesisë së kësaj akademie. Morën pjesë rreth 20 artistë, kuratorë, studiues arti dhe arkitektë nga vendi dhe Bota.

Drejtori i Qendrës së Studimit të Arteve akad. asoc. Stefan Çapaliku dhe artisti italian dr. Stefano Romano (kërkues shkencor pranë QSA), koordinator, çelën konferencën.

Akad. asoc. Çapaliku u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe bashkëpunëtorëve dhe tha se kjo konferencë synon qasjen ndaj hapësirës urbane përmes këndvështrimit të artistit, reflektimin për formën dhe vlerën që mund të marrin arti dhe kultura kur praktikohen si e mirë e përbashkët dhe diskutime për format e artit publik apo ndërhyrjet në hapësirat publike, që nga kornizimi i këtij arti deri tek projektet neoliberalet të qeverisjes, e më gjerë.

Akad. asoc. Çapaliku ia dha fjalën folësit kryesor të konferencës, dr. Vincent Van Gerven Oei-t, i cili prezantoi në mënyrë të zgjeruar temën “Lapidarët e qiellgërvishtësit

si propagandë monumentale". Më pas, dr. Alessandro Gallicchio mbajti referatin me temën "Edi Hila: Të pikturosh hapësirat e Shqipërisë bashkëkohore".



Në seancën e parë u trajtua edhe një nga çështjet më të prekshme, siç është ajo e godinës së Teatrit Kombëtar në Shqipëri nga dr. Anxhela Çikopano dhe dr. Alert Çeloaliaj.



Në vijim të kësaj konference dyditore, pjesëmarrësit e tjerë si Valerio Perna, Francesco Scasciamacchia, Claudio Musso, dr. Alessandro Gallicchio, dr. Raino Isto, dr. Francesco Scasciamacchia, dr. Claudio Musso, Arba Bekteshi, Pleurad Xhafa, dr. Nickolas Lambrianou, dr. Agron Mesi, Diana Mile, dr. Fabiola Naldi, Melody Robine, dr. Adriana Duka, Edi Muka, e të tjerë trajtuan çështje të përfaqësimit dhe pakënaqësitë në lidhje me hapësirën publike, si dhe çështje të rikonceptimit të kuptimit të hapësirës publike, të përmirësimit të mjedisit urban, të përkufizimit të hapësirave që përshkohen nga një komponent imagjinar e krijues. Çështjet u trajtuan në perspektiva kritike për projektimin dhe konceptimin e hapësirës publike, siç janë perspektiva ontologjike dhe epistemologjike, duke eksploruar sesi kjo praktikë kontribuon në vizualizimin e një imazhi të ri të qytetit dhe një identiteti të ri, megjithëse të fragmentuar, të hapësirës urbane.



Temat e diskutuara përfshinë vertikalisht, të lidhur me kujtesën historike, veçanërisht në lidhje me zhvillimin aktual arkitekturor të Tiranës. Diskutimet prekën kolapsin e peizazhit në qytet, duke u thelluar në çështjet ekologjike dhe transformimet që ndryshimet klimatike po sjellin në imazhin e qytetit dhe perceptimin tonë për të.

Temat kryesore përfshinë ndërtesat ikonike në qytet dhe marrëdhëniet mes qendrës dhe periferisë, me fokus në raste specifike si Piramida e Tiranës dhe Teatri Kombëtar. Konferenca eksploroj gjithashtu potencialin për të nxitur forma të reja ndërveprimi dhe socializimi në hapësirat publike përmes lojës, duke theksuar idenë e

kulturës si një e mirë e përbashkët.

Diskutimet e tjera u përjasën rreth monumentalitetit dhe paaftësisë për të përfaqësuar botën bashkëkohore pas modernizmit. Së fundi, u hulumtuan edhe temat e pronësisë intelektuale për veprat në hapësira publike, përdorimi i mundshëm i fshirjes si mjet metodologjik, ideja e ritualitetit dhe transformimi i hapësirave publike përmes negociatave.

Të gjitha këto tema do të zhvillohen më tej në publikimin e punimeve të konferencës, të cilat do të përfshijnë kontribute nga të gjithë folësit në muajt e ardhshëm.

www.akad.gov.al

U zhvillua në Prishtinë seminari vjetor NanoAlb/ NanoBALKAN-NanoALB Workshop 2024 dhe Forumi Kuarc



- U prezantua kërkimi shkencor gjatë vitit 2024 në grupet e qendrës NanoAlb- Workshop-i vjetor NanoAlb/NANO BALKAN dhe Forumi Kuarc u zhvilluan në datat 16-17 dhjetor 2024, në Universitetin “Hasan Prishtina” në Prishtinë, Kosovë. Ky seminar u organizua në bashkëpunim me projektet e mbështetur nga BE SUSNANO (<https://www.susnano.eu/>) dhe NANOKOS (<https://www.nanokos.org/>).

Projekti SUSNANO i koordinuar nga Universiteti i Tiranës synon të zgjerojë dhe forcojë bashkëpunimin dhe rezultatet me grupet NanoALB në lidhje me përgatitjen dhe aplikimin e nanobiosensorëve për monitorimin e cilësisë së ujërave.

Workshopi synoi të prezantojë dhe diskutojë arritjet shkencore të rrjetit NanoAlb-NANO BALKAN dhe partnerëve të tij gjatë vitit 2024.

Dita 1: NanoAlb Ignite Projects (16 dhjetor 2024)

Dita e parë u fokusua në rezultatet e 6 NanoAlb Ignite Projects (2024-2026), të mbështetur financiarisht nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Prezantimet theksuan kontributet nga partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë, duke nxitur diskutimet për

zgjerrimin e bashkëpunimit me projekte të tjera për të maksimizuar përfitimet.



Dita 2: Forumi i Kuarcit (17 dhjetor 2024)

Dita e dytë iu kushtua Forumit të Kuarcit, me temë “Ripërcaktimi i së nesërme përmes Nano Inovacionit”. Ky forum nënvizoi rolin kritik të studiuesve të rinj në adresimin e sfidave globale përmes përparimeve në nanoshkencë.

Një sesion i veçantë, në bashkëpunim me projektin NANOKOS, i financuar nga Komisioni Europian, u fokusua në ngritjen e kapaciteteve në kërkimin mjedisor dhe nanomjekësi në Kosovë. Pjesëmarrësit u ftuan për një vizitë në Fakultetin e Mjekësisë, dhe vizituan një nga laboratorët e rij të ndërtuar sipas standardeve europiane dhe të pajisur me aparatura të reja dhe moderne në kuadër të projektit NANOKOS.

Gjithashtu, u prezantua edhe rrjeti AWIN - Gratë Shqiptare në Nanoteknologji, pjesë përbërëse e NanoALB-NANOBAKLAN. Pjesëmarrësit në workshop u ftuan të vizitojnë STEM Lab në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Prishtinës. Ky laborator inovativ shfaq projektet e tij magjepsëse, duke përfshirë realitetin e shtuar, sistemet elektronike plotësisht të integruara, robotikën dhe më shumë, duke u ofruar pjesëmarrësve një prezantim tërheqës në punën e tij të fundit.

NanoAlb përparon drejt NANOBAKLAN

Gjatë seminarit, u prezantuan përditësime mbi evoluimin e NanoALB në NANOBAKLAN, një Qendër Rajonale për Nanoshkencën dhe Nanoteknologjinë. Me rritjen e aktiviteteve rajonale, NANOBAKLAN është krijuar si një qendër virtuale që bashkon 30 grupe kërkimore nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Greqia, Serbia dhe grupe të asociuara nga Izraeli, Italia dhe Spanja.

NANOBAKLAN ndjek modelin e Institutit Katalan të Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë (ICN2) në Barcelonë, Spanjë, një institucion kërkimor me famë ndërkombëtare. Duke pranuar grupe kërkimore rajonale dhe duke krijuar partneritete me grupe të binjakëzimit në mbarë botën, NANOBAKLAN nxit bashkëpunimin, përsosmërinë dhe inovacionin teknologjik.



Ceremonia e hapjes filloi me fjalët e mirëseardhjes nga prof. Fetah Podvorica, mikpritës i seminarit nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe koordinator i grupeve NanoAlb në Kosovë; z. Kastriot Noli, Sekretar i Parë i Ambasadës së Shqipërisë në Kosovë dhe prof. Avni Hajdari, prorektor për Hulumtime në Universitetin e Prishtinës.

Prof. Arben Merkoçi, profesor ICREA në ICN2 në Barcelonë, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe drejtor i NanoALB, mbajti një prezantim të shkurtër për NanoALB dhe ecurinë e tij drejt shndërrimit në NANOBAKLAN. Workshopi mirëpriti gjithashtu z. Sinisa Marcic, ekspert i lartë për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), i cili mbajti një prezantim të titulluar "Drejtimet e

Inovacionit Rajonal: Fuqia Ekonomike e Investimeve të Synuara në Infrastrukturat Kërkimore”.

Planet e ardhshme të NANOALKAN përfshijnë:

- Mundësimi i eksperimenteve në distancë dhe komunikimit ndër-laboratorik në të gjithë rajonin.

- Promovimi i përsosmërisë shkencore në të gjithë rajonin, sigurimi i financimit konkurrues të BE-së dhe inkurajimi i investimeve private në industritë e teknologjisë së lartë.

- Krijimi në të ardhmen (afatgjatë) i qendrave satelitore të përshtatura për nevojat unike të çdo vendi.

Qeveria shqiptare ka akorduar tashmë një godinë në Tiranë për NANOALKAN. Megjithatë, nevojiten fonde urgjente për të përshtatur objektin, për të krijuar infrastrukturën laboratorike dhe për të punësuar staf me kohë të plotë. Arritja e këtij qëllimi do të kërkojë përpjekje kolektive nga qeveritë rajonale, institucionet dhe Komisioni Evropian si pjesë e prioritetëve të financimit për vendet e Ballkanit/lindore.

Konkluzionet

Workshopi NANOALKAN-NANOALB 2024 shërbeu si një platformë e jashtëzakonshme për evidentimin dhe promovimin e përparimeve në nanoshkencë, nxitjen e bashkëpunimeve dhe forcimin e lidhjeve midis grupeve kërkimore NANOALKAN. Nevoja urgjente për mbështetje financiare nga qeveritë rajonale dhe BE-ja për krijimin e qendrës fizike rajonale u theksua si një hap kritik për përparimin e kësaj nisme. Për më shumë informacion mbi programin e seminarit, vizitoni:

www.nanoalb.al

P.S: Bashkëlidhur gjeni programin dhe posterin e workshop-it

Programi: <https://www.facebook.com/share/p/aVkCmZGmS6y3aV9A/>

www.akad.gov.al

Në Akademinë e Shkencave u mbajt një koncert me veprat e kompozitorëve më të njohur mbarëshqiptarë



Më 16 dhjetor 2024, ora 11.00, në sallën "Aleks Buda", në Akademinë e Shkencave, Komisioni i përhershëm i artit pranë kësaj akademie organizoi një koncert me muzikë pianistike dhe dhome me veprat e kompozitorëve më të njohur mbarëshqiptarë, ku u përfshinë vepra të krijuesve nga Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi.

Ishte i pranishëm Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi dhe anëtarët e Kryesisë së kësaj akademie, si dhe akademikë e studiues të njohur të fushave të ndryshme të shkencës dhe të artit.

Koncerti u çel nga akad. Vasil Tole, i cili iu uroi mirëseardhjen të pranishmëve. Ai falënderoi organizatorët e kësaj veprimtarie dhe shprehu vlerësimin e tij për veprat pianistike të kompozitorëve mbarëshqiptarë, për rolin dhe vendin që zënë në historinë e muzikës shqiptare dhe foli më tej për veçoritë e krijimtarisë së tyre.

Koncerti nisi me interpretimet e dy artisteve të reja Nikol Tupa dhe Hepi Kajca, të cilat luajtën në piano veprat e kompozitorëve shqiptarë të Kosovës; "Alla turca" të Fahri Beqirit, "Valle e zanave", "Arie" dhe "Fuga.nr.3" të Rauf Dhomit, "Prishtina Blues" të Rafet Rudit, dhe "Alla Toccata" të Valton Beqirit.

Pas këtyre interpretimeve, që u pëlqyen dhe u duartrokitën nga të pranishmit, u interpretuan veprat pianistike të kompozitorëve të njohur Fehim Ibrahim Zarko

Mirkoviç, Thomas Simaku, Vasil S.Tole.



Veprën e Fehim Ibrahimit “Abel (es) Meditation”, e luajti në piano e bija e kompozitorit, pianistja e njohur Etrita Ibrahim, ndërsa veprën “Albanian folk song My beautiful Morea” e interpretuan violinisti Gëzim Bulcari me pianisten Etrita Ibrahim.

Vepra e akad. Vasil S. Toles “Agoj 3”, temë me 12 variacione, u luajt në piano nga Ardita Bufaj

Në fund, koncerti u mbyll me veprën e Zarko Mirkoviç “Taraf trio”, që u interpretua në violinë nga Laura Llozi, në klarinetë në LA Çlirim Baruni dhe u shoqërua në piano nga Ardita Bufaj.

www.akad.gov.al

U mbajt veprimtaria “Kujtojmë prof. Agron Ficon” me rastin e 90-vjetorit të lindjes

- Jepet diploma e mirënjohjes me titullin “Nderi i Akademisë” për prof. Agron Ficon



Më 16 dhjetor 2024, në orën 13:00, në sallën “Aleks Buda” në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u organizua veprimtaria “Kujtojmë prof. Agron Ficon” me rastin e 90-vjetorit të lindjes.

Në këtë veprimtari ishin të pranishëm Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi, anëtarë të kryesisë së kësaj akademie, ambasadorja e Kinës në Shqipëri, znj. Pang Chunxue, personalitete të njohura, familjarë të prof. Agron Ficos etj.

Akad. Vasil S. Tole, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, mbajti një fjalë përshëndetëse në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave. Ai tha se prof. Agron Fico kujtohet për kontributet e tij në fushën e pedagogjisë, në fushën e shkencave albanologjike dhe për mundësimin e njohjes dhe përhapjes së gjuhës shqipe si

përkthyes në tri kontinente. Agron Fico ishte folkloristi dhe studiuesi i njohur i etnokulturës, që e nisi udhën me ekipin themelues të Institutit të Folklorit në vitin 1958. Më pas ai punoi si i pari sekretar shkencor i Institutit të Gjuhës dhe Historisë në vitet 1958-62, ku dha leksione për folkloristikën në Akademinë e Arteve.

Gjithashtu, akad. Toke kujtoi edhe meritat e tij për bashkëpunimin me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë si anëtar i Komisionit të artit pranë kësaj akademie. Më tej, akad. Toke vuri në dukje përpjekjet e vazhdueshme të prof. Agron Ficos për ruajtjen e identitetit dhe integritetit të kombit shqiptar nëpërmjet shkrimeve dhe eseve të publikuara.

Pas fjalës përshëndetëse të akad. Toles, nisi veprimtaria përkujtimore me paraqitjen nga akad. Floresha Dado të botimit “Një hap i ri me kohën” të prof. Agron Ficos. Ajo tha se ky libër është një përmbledhje studimesh dhe artikujsh e problematikash i ndarë në disa rubrika: personalitetet e njohura të kulturës; njohuri për aktivitetin diplomatik dhe atdhetar të Rauf Ficos; vlerësim me dekorata të ndryshme nga vende të Europës e botës etj.



Akad. Dado u kujtoi se ai është bashkëthemelues i dy katedrave të shqipes në Kinë, që u hap në vitin 1961 në Institutin e Gjuhëve të Pekinit. Më vonë ai themeloi edhe katedrën e shqipes në Boston. Prof. Fico është një personalitet me shumë kontribute në fushën e botimeve dhe prezantimeve në konferencat shkencore.

Akad. Dado tha se libri që promovohet zbulon një portret të spikatur me të gjitha kontributet në trashëgiminë historike, shkencore dhe akademike. Ky libër doli në dritën e botimit me kontributin e dy bijave të prof. Ficos, Albanës e Delinës dhe bashkëshortes Liri Fico.

Engjëll Musai mbajti një kumtesë për profilin e prof. Agron Ficos, si personalitet i kulturës sonë kombëtare. Ai tha se prof. Fico ka përfaqësuar shkencën dhe kulturën shqiptare në një varg konferencash shkencore, kombëtare dhe botërore.

Pas kësaj kumtese, akad. Tole ftoi Kryetarin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi, për të dhënë diplomën me titull “Nderi i Akademisë” për prof. Agron Ficon, akorduar nga kryesia e ASHSH-së.



Akad. Gjinushi tha se Agron Fico është fitues i mirënjohjes “Nderi i Akademisë” me motivacionin:

“Studiues me profil të veçantë në folkloristikë dhe profesor i pasionuar i shqipes për të huajt në disa vende të botës; anëtar i komisionit të përhershëm të artit dhe trashëgimisë kulturore pranë Akademisë së Shkencave; drejtues që la gjurmë në disa institucione kërkimore-shkencore të vendit dhe që, me studimet, botimet dhe referimet e tij, lartësoi kudo traditat kulturore dhe trashëgiminë shqiptare.”

Ai ia dorëzoi diplomën bashkëshortes së prof. Ficos, znj. Liri Fico, e cila shprehu falënderime të përzemërta për kryesinë e ASHSH-së.

Në fund të kësaj veprimtarie, vajza e prof. dr. Agron Ficos, prof. as. dr. Albana Fico, mbajti fjalën e rastit. Fillimisht ajo falënderoi kryesinë e Akademisë së Shkencave dhe organizatorët e veprimtarisë dhe pjesëmarrësit në emër të familjes. Më tej, ajo rrëfeu kujtimet e saj dhe vuri në dukje disa nga kontributet e prof. Agron Ficos dhe përpjekjet e tij personale si gjuhëtar e albanolog.

Veprintaria u mbyll me interpretimin në piano nga Ardita Bufaj të veprës
“Amen”, kompozim i akad. Vasil S. Toles.

www.akad.gov.al


U zhvillua konferenca shkencore përkujtimore “Poliedriciteti i prof. Jup Kastratit dhe mbarëkombëtarja në studimet e tij”.

Sot më 13 dhjetor 2024 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua konferenca shkencore përkujtimore “Poliedriciteti i prof. Jup Kastratit dhe mbarëkombëtarja në studimet e tij”. Kjo veprimtari u organizua me rastin e 100-vjetorit të lindjes së studiuesit dhe albanologut të shquar në bashkëpunim me fondacionin “Jup Kastrati” dhe Fakultetin e Histori Filologjisë.

Në konferencë mori pjesë Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi dhe anëtarë të tjerë të Kryesisë, si dhe personalitete që kanë njohur kontributet e vyera në fushën e historisë së albanologjisë, si dhe botimet e monografitë për figurat e shquara të letrave shqipe të Jup Kastratit.

Seanca e parë u moderua nga prof. Persida Asllani dhe prof. Anila Omari.

Veprimtaria u çel me fjalën e akad. Rexhep Qosjes përmes një materiali të regjistruar në video.



Akad. Qosja tha se prof. Jup Kastrati ka një krijimtari madhështore me rëndësi monumentale për albanologjinë. Më tej, ai vlerësoi punën kolosale, sakrificat dhe përkushtimin që ka bërë prof. Kastrati për veprën “Historia e albanologjisë”, ku zbulohen

edhe shkrimet parashkencore për këtë disiplinë.

Akad. Qosja rrëfeu gjithashtu edhe kujtimet nga takimet me prof. Kastratin dhe bashkëpunimet që kanë pasur me diasporën.

Më pas, e bija, Fatmira Kastrati (Sykja) foli për trashëgiminë intelektuale të studiuesit Jup Kastrati dhe për fondacionin që mban emrin e tij. Ajo tha se ngritja e fondacionit ishte një amanet i prof. Kastratit dhe vuri në dukje misionin, funksionet dhe perspektivat e këtij fondacioni.



Gjuhëtari dhe studiuesi i njohur akad. Gjovalin Shkurtaj foli për ndihmesën e prof. Jup Kastratit në lëmin e dialektologjisë dhe të onomastikës shqiptare e arbëreshe.

Ai e vuri theksin tek kontributet e prof. Kastratit për të gjetur e përcaktuar vendin e së folmes së Thethit në kuadrin e ndarjes dialektore të shqipes. Me interes për dialektologjinë shqiptare janë edhe një numër studimesh të tjera të Jup Kastratit, si: “Të dhënat e të folmeve të arbëreshëve të Italisë për historinë e gjuhës shqipe”; “Mbi ekzistencën e difongut në gjuhën shqipe”, “Diftongu në gjuhën shqipe”, “ë-ja atone në shqipet.”, etj. Akad. Shkurtaj vuri në dukje edhe disa artikuj kushtuar onomastikës arbëreshe.

Prof. Begzad Baliu në kumtesën e tij e vlerësoi prof. Kastratin si një rilindës të përjetshëm të albanologjisë.

Prof. Anila Omari në kumtesën “I dashuni Mjeshtër! Çështje gjuhësore në Epistularin e Jup Kastratit me At Justin Rrotën” përgëzoi, së pari, për përkushtimin profesional vajzat e prof. Kastratit, Fatmirën dhe Dianën, për botimin e veprës “EPISTULAR. Prof. Jup Kastratit - At Justin Rrota O.F.M 1951-1964”, me letërkëmbimin

e vyer mes prof. Jup Kastratit dhe At Justin Rrotës, që përfshin një periudhë 13- vjeçare.

Prof. Omari zbulon përmes këtij letërkëmbimi informacione të rëndësishme për historinë e albanologjisë dhe shumë çështje shkencore të trajtuara në dialogun e vazhdueshëm mes tyre.



Ajo u ndal në disa çështje me interes gjuhësor, si edhe në disa letra e artikuj qe trajtojnë probleme të vendlindjes dhe gjuhës së Gjon Buzukut me rastin e 400-vjetorit të Mesharit të tij. Me tej, prof. Omari i cilësoi prof. Jup Kastratin dhe At Justin Rrotën si përfaqësues të një brezi të nderuar idealistësh me frymëzim rilindas.

Prof. Agim Vinca përmes kumtesës së tij “Jup Kastrati dhe Jeronim de Rada (Si e zbuluam De Radën ne studentët e Prishtinës)”, shprehu vlerësimin për kontributin që kanë dhënë dy figurat e shquara, Jup Kastrati dhe De Rada, në lëmin e albanologjisë.

Figura e Jup Kastratit është vlerësuar edhe nga prof. Ferdinand Leka përmes një materiali të regjistruar në video.

Dr. Vjollca Osja prezantoi profilin e Jup Kastratit në studimet letrare, ndërsa prof. Diana Kastrati foli për personalitetin shumëplanësh të studiuesit në veprën “EPISTULAR Prof Jup Kastrati – At Justin Rrota O.F.M 1951 – 1964”.

Dr. Kastriot Gjika foli për veprën e prof. Kastratit “Marrëdhënia e Faik Konicës me F. S. Nolin nën dritën e një monografie”.

Prof. Evalda Paci prezantoi të dhëna bibliografike mbi Mesharin e Gjon Buzukut, të cilat i vlerësoi si orientime të vyera nga prof. Jup Kastrati.
Sesioni i dytë u moderua nga prof. Evalda Paci



Së pari, për figurën e prof. Kastratit foli Damiano Guagliardi - President i FAA- Federatës së Shoqatave Arbëreshe përmes një materiali të regjistruar në video.

Më pas, prof. Persida Asllani mbajti një kumtesë për kontributin e prof. Jup Kastratit në studimet deradiane. Ajo vuri në dukje interesimin e tij për letërsinë e arbëreshëve të Italisë, lidhur me përkushtimin dhe dimensionet e shumanshme të prof. Kastratit për De Radën.

Për profilin e prof. Jup Kastratit, si studiues të letërsisë arbëreshe, foli përmes një materiali të regjistruar në video, edhe studiuesja Klara Kodra.

Për kontributin e Jup Kastratit në fushën e studimeve gjuhësore dhe filologjike shqiptare folën edhe prof. Emil Lafe, dr. Jolanda Lila, prof. Tef Topalli: dr. Loreta Loli, dr. Arta Sula e të tjerë.

www.akad.gov.al

U zhvillua konferenca shkencore "E kaluara në të tashme" - Ruajtja, digjitalizimi dhe rëndësia e fondeve etnografike dhe arkivave të trashëgimisë kulturore në bashkëkohësi



Sot, më 12 dhjetor 2024, Instituti i Antropologjisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizoi në sallën "Rrok Zojzi" të këtij instituti konferencën shkencore "E kaluara në të tashme" - Ruajtja, digjitalizimi dhe rëndësia e fondeve etnografike dhe arkivave të trashëgimisë kulturore në bashkëkohësi.

Ishin të pranishëm Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi; prof. asoc. Olsi Lelaj, drejtor i Institutit të Antropologjisë; prof.asoc. dr. Ardit Bido, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave; dr. Gentiana Sula (Autoriteti mbi Informimin e Sigurimit të Shtetit); z.Devis Xhaja, drejtor i Drejtorisë së Arkivave në RTSH, si dhe studiues, arkivistë, kuratorë e përfaqësues të komuniteteve të ndryshme kulturore, mes të cilëve prof. dr. Afërdita Onuzi, znj. Marinela Ndria, drejtore e Arkivit Qendror Shtetëror të filmit, prof.dr. Pirro Thomo, dr. Ervin Kaçiu, dr. Ermela Broci, dr. Mimoza Shqefni, etj.

Prof. asoc. Olsi Lelaj, çeli veprimtarinë dhe vuri në dukje synimet e kësaj konference për mirëmbajtjen, digjitalizimin dhe rëndësinë bashkëkohore të fondeve

etnografike dhe lëndës arkivore që ruhet në Institutin e Antropologjisë. Ai tha se çështja nuk është e izoluar vetëm për koleksionet etnografike apo të trashëgimisë kulturore, por apelon për të gjithë praktikën arkivuese në tërësi.



Prof.asoc. Lelaj ia dha fjalën Kryetarit të ASHSH, akad. Skënder Gjinushit.

Akad. Gjinushi foli për rëndësinë e ruajtjes së koleksioneve arkivore të fondeve të trashëgimisë kulturore dhe arkivave në tërësi në shoqërinë e sotme dhe rëndësinë e digjitalizimit për të zgjeruar aksesin e publikut dhe për të siguruar jetëgjatësinë e koleksioneve etnografike, trashëgimisë kulturore apo dokumenteve.

Gjatë zhvillimit të kësaj konference, u mbajtën referate mbi politikat e ruajtjes së dokumentit arkivor, për punën që është bërë për kalimin nga dokumenti fizik tek ai digjital, konservimin dhe zbardhjen e së vërtetës historike, si dhe për politikat e digjitalizimit në RTSH.

U diskutua për rëndësinë e restaurimit të trashëgimisë filmike shqiptare përkundrejt stigmatizimit që karakterizon artin e krijuar nën diktaturë, dokumentimin dhe regjistrimin e objekteve në muze. U trajtuan, gjithashtu, disa çështje themelore të arkivave të Institutit të Antropologjisë, e ardhmja e fondeve etnografike, muzeu digjital midis sfidave dhe mundësive, sfidat e ruajtjes dhe digjitalizimit të trashëgimisë kombëtare filmike, etj.

Një çështje me interes ishte rijetëzimi i koleksioneve etnografike në bashkëkohësi. Pjesëmarrësit diskutuan strategjitë dhe metodologjitë për ruajtjen e materialeve etnografike, trashëgimisë kulturore apo dokumenteve.



Më tej u fol dhe u diskutua për digjitalizimin dhe 'open access', si dhe për ekzaminimin e iniciativave të digjitalizimit.

Në fund, u diskutua për rolin e koleksioneve etnografike, fondeve të trashëgimisë kulturore dhe arkivave në tërësi në shoqërinë e sotme. Pjesëmarrësit në këtë konferencë trajtuan problematikat dhe dhanë opinionin e tyre për ndikimin ka lënda arkivore mbi identitetet e bashkësive lokale, komuniteteve etnike dhe formacioneve kombëtare, si dhe për qasjet që përfshijnë komunitetet në administrimin dhe interpretimin e trashëgimisë së tyre kulturore, duke siguruar që koleksionet të mbeten relevante dhe reflektuese të identiteteve bashkëkohore.



U zhvillua konferenca e parë shkencore “Mjedisi urban - binomi: ndërtim - gjelbërim urban”



Në datat 1 - 2 dhjetor 2024, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi punimet konferenca e parë shkencore “Mjedisi urban - binomi: ndërtim - gjelbërim urban (1st International Conference Urban Environment, “Binomial: Construction - Urban greening”).

Kjo konferencë u organizua në bashkëpunim me Universitetin Metropolitan Tiranë dhe AKKSHI-n.

Morën pjesë: Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi; zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave akad. Vasil S.Tole; presidenti i Universitetit Metropolitan të Tiranës prof. dr. Arjan Çukaj; kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. Gëzim Hoxha, si dhe kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike akad. Neki Frashëri, e të tjerë. Morën pjesë gjithashtu, akademikë, studiues dhe përfaqësues të pushtetit vendor e shoqërisë civile.

Konferenca i zhvilloi punimet me më shumë se 50 pjesëmarrës të pranishëm në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave dhe me pjesëmarrjen online të studiuesve nga Turqia, Franca, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut, etj.

Veprimtarinë e çeli prof. dr. Hajri Haska, i cili i dha fjalën akad. Neki Frashërit. Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave akad. Frashëri përshëndeti pjesëmarrësit dhe falënderoi organizatorët e kësaj konference. Konferencën e përshëndeti edhe rektori i UMT-së prof.dr.Nikolla Civici.

Më tej, vijoi seanca e parë plenare me paraqitjen e dy referateve kryesore. Prof. dr.

Hajri Haska paraqiti punimin shkencor lidhur me infrastrukturat e gjelbra në zonat urbane, si një komponent kyç për një mjedis të qëndrueshëm dhe cilësi të jetës në komunitet.



Prof. dr. Neritan Shkodrani me grupin e tij të punës paraqiti një punim shkencor për ecurinë e ndikimeve mjedisore nga sektori i ndërtimit në territorin e bashkisë së Tiranës.

Konferenca vijoi përgjatë dy ditëve me katër sesione shkencore.

Përveç prezantimeve të punimeve shkencore kryesore u paraqitën edhe rreth 20 punime të tjera me nivel të lartë shkencor.


Ne fund, konkluzionet e konferencës u bënë nga prof.dr.Hajri Haska, i cili falënderoi të gjithë pjesëmarrësit. Ai vuri në dukje se vetë punimet e paraqitura në këtë konferencë shënojnë suksesin e saj, sepse u trajtuan çështje specifike të lidhura ngushtë me ndërtimin dhe gjelbërimin urban. Ai falënderoi veçanërisht prezantuesit e punimeve shkencore, dhe tha se punimet e konferencës do të botohen në procedings në të ardhmen nën logon e ASHSH-së dhe punime të zgjedhura do të botohen në revistën AJNTS dhe EJFE.

Për më tepër rreth kësaj konference klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://www.facebook.com/share/v/tXbPdwfksttZZDyA/>
www.akad.gov.al

Promovime

**60-vjetori: Promovohet numri i fundit i revistës shkencore “Studia albanica”,
botim i Akademisë së Shkencave**



Revista “Studia albanica” është një revistë shkencore që botohet dy herë në vit nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e themeluar në vitin 1964. Në pjesën më të madhe të kohës revista është botuar në gjuhën frënge dhe në dhjetë vitet e fundit botohet në gjuhën angleze.

Në 60 vitet e botimit të saj, revista shënon mbi 100 numra. Kjo revistë boton përzgjedhjet më të mira vjetore të studimeve shoqërore dhe albanologjike.

Në këtë 60-vjetor, akad. Gëzim Hoxha tha se kjo revistë është një arritje në botimet shkencore të Akademisë së Shkencave.

Më tej, ai paraqiti numrin e fundit të “Studia albanica”, që ka 257 faqe, ku janë publikuar 8 artikuj.

Artikulli kryesor “Shteti i së drejtës në proceset integruese të Shqipërisë” (vështrime të studiuesve të së drejtës në diasporë) është përgatitur nga akad. Aurela

Anastasi dhe akad. Shaban Sinani. Me punimet e botuara në këtë përmbledhje, të përgatitura nga studiuesit në diasporë dhe nga juristë brenda vendit, kemi rastin të nxisim mendimin juridik për të nxjerrë mësim për shtetin e të drejtës në Shqipëri. Në këto punime shpërfaqen njohuri të gjera e të thelluara, duke sjellë në vëmendje respektimin e standardeve ndërkombëtare, si dhe duke analizuar në një vështrim kritik situatën e shtetit të së drejtës në Shqipëri, në kuadrin e integritit të tij në Bashkimin Europian.



Katër artikuj të fushës gjuhë-letërsi janë përgatitur nga prof.dr. Tomor Plangarica, dr. Linda Mëniku, akad. Matteo Mandala, prof.dr.Evalda Paci. Në gjuhësi trajtohen çështje të dukurive të shfaqura përgjatë përdorimit të gjuhës, të shkencës së ligjërimit, si dhe gjuhësia e diskursit në mendimin gjuhësor shqiptar-një hapësirë shqyrtimeve që duhet plotësuar.

Artikull i fushës së historisë është përgatitur nga prof. dr.Irakli Koçollari.

Dy artikuj për arkitekturën dhe për planifikimin urban janë përgatitur nga prof.dr. Besnik Aliaj e dr.Sotir Dhamo dhe prof.asoc.dr. Godiva Rëmbeci e dr. Armela Leka, ku trajtohen banesat në Shqipëri gjatë viteve '45 -'90 dhe çështje të planifikimit urban.


Në këtë numër janë publikuar edhe katër recensione nga akad. Shaban Sinani, akad. Adem Bunguri e prof.dr. Evalada Paci dhe 6 kronika.



Akad. Gëzim Hoxha kryeson bordin editorial të këtij numri të përbërë nga akad. Pëllumb Xhufi, akad. Shaban Sinani, prof. asoc. Aljula Jubani, dr. Enkelejda Kapia, akad. Kristina Jorgaqi, prof.dr. Ksenofon Krisafi, Lorenc Bejko, prof.asoc.dr. Marenglen Kasmi, akad.Matteo Mandalà.

www.akad.gov.al

Një paraqitje e arritjeve të revistës “Studime historike” me rastin e 60-vjetorit të saj



Revista “Studime historike” është një revistë shkencore e Institutit të Historisë e specializuar në botimin e studimeve në trajtën e artikujve shkencorë dhe shkrimeve, që lidhen me historinë e shqiptarëve në rajonin e Europës Juglindore dhe më gjerë që nga periudha e mesjetës deri në ditët tona.

Gjatë 60 viteve të ekzistencës së kësaj reviste, janë publikuar rreth 2404 tituj në trajtën e artikujve shkencorë, kumtesave, dokumenteve e materialeve historike. Revista “Studime historike” është vazhduese e revistës “Buletin i Institutit të Studimeve”, që publikohej në vitin 1947, e revistës “Buletin i Institutit të Shkencave” (1948-1952), e më tej e revistës “Buletin për shkencat shoqërore” (1952-1957), dhe, së fundi, e revistës “Buletin i Universitetit të Tiranës - seria shkencat shoqërore” (1957-1964). Nga nr. 1, 1964 e deri

në nr. 4, 1971, revista “Studime historike” ishte organ i Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës, ndërsa nga nr. 1, 1972 e deri në nr. 4, 1972, kjo revistë ishte organ i Institutit të Historisë pranë Universitetit Shtetëror të Tiranës.



Krijimi i Akademisë së Shkencave në vitin 1972, natyrisht që solli një ristrukturim të institucioneve shkencore. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, u nda përkatësisht në Institutin e Historisë dhe në Institutin e Gjuhës e të Letërsisë, të cilët ishin ndër institucionet kryesore të albanologjisë në Akademinë e Shkencave. Në këtë rrjedhë ndryshimesh, revista “Studime historike” që nga nr. 1, 1973 e deri në vitin 2008, ishte organ shkencor i Institutit të Historisë pranë Akademisë së Shkencave.

Gjatë kësaj periudhe, revista vijoi të botohej katër herë në vit deri në vitin 1991, ku pasqyrohej veprimtaria shkencore e dhjetëra studiuesve të Institutit të Historisë, të cilët publikonin rregullisht në këtë revistë. Artikujt shoqëroheshin me një përmbledhje të shkurtër në gjuhën frënge. Ndërkohë, pasqyra e lëndës jepej në gjuhën frënge dhe atë ruse. Më vonë, në vitet ‘90 e në vijim, u vendos që përmbledhja e materialeve të revistës dhe pasqyra e lëndës të jepej në gjuhën angleze.

Gjatë rrugëtimit të saj, materialet e botuara në këtë revistë janë paraqitur përgjithësisht sipas shtatë rubrikave. Në rubrikën e parë, janë botuar kryesisht artikujt shkencorë problemorë; në të dytën, kanë zënë vend probleme e diskutime mes studiuesve

për çështje dhe probleme të ndryshme historike; në rubrikën e tretë, janë publikuar kryesisht kumtesa të mbajtura në veprimtari të ndryshme shkencore (konferenca, simpoziume etj.); në rubrikën katërt, “dokumente e materiale” janë publikuar dokumente arkivore me rëndësi, pjesë kujtimesh e materiale të zgjedhura me karakter historik; në të pestën, janë pasqyruar materiale në trajtën e “kritikës dhe bibliografisë”; në rubrikën e gjashtë, është paraqitur “jeta shkencore”, ku zakonisht janë pasqyruar të dhëna nga veprimtaritë shkencore të organizuara nga Instituti i Historisë, ose aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit, ku kanë marrë pjesë studiuesit e këtij instituti. Herë pas here, është dhënë informacion edhe për botimet e Institutit të Historisë; dhe së fundi sipas rasteve, janë paraqitur shkrime përkujtimore dhe nekrologji kushtuar studiuesve të nderuar shqiptarë dhe të huaj me kontribute të çmuara në fushën e historisë e më gjerë.



Ndër vite redaksia e revistës është drejtuar nga Stefanaq Pollo (1964-1991), Kasem Biçoku (1992-1996), Ana Lalaj (1997-2005), Marenglen Verli (2005-2007), Beqir Meta (2008-deri në nr. 1-2, 2021), Afrim Krasniqi (nga nr. 3-4, 2021 deri në nr. 1, 2023), Hamit Kaba (nga nr. 2, 2023 – vijim).

Aktualisht, redaksia e revistës “Studime historike” synon ruajtjen e traditës së krijuar ndër vite, forcimin e nivelit shkencor të saj si dhe shtimin e prurjeve cilësore shkencore jo vetëm nga studiuesit shqiptarë, por edhe ata të huaj që merren me historinë e shqiptarëve. Edhe këtë vit, revista “Studime historike” në nr. 1, 2024, vjen me 241 faqe.

Në këtë numër janë paraqitur 8 artikuj shkencorë si dhe një material dokumentar. Nga artikujt e publikuar, gjysma e tyre janë paraqitur nga studiues të Institutit, ndërsa pjesa tjetër nga studiues që vijnë jashtë Institutit të Historisë. Për numrin 2, 2024 që aktualisht është thujse në përfundim dhe gati për t'u publikuar janë paraqitur 7 artikuj shkencorë, një kumtesë dhe dy materiale përkujtimore kushtuar profesorëve të ndjerë Hysen Kordha dhe Liman Rushiti.



Prej vitit 2022, revista "Studime historike" i ka vënë vetes si objektiv përshtatjen e saj me synim indeksimin e saj si një revistë me faktor impakti. Për të plotësuar kriteret e kërkuara, nga viti 2022 e deri tani janë bërë disa ndryshime:

1. Krijimi i Bordit të ri të revistës, i përbërë nga profesorët më të njohur të fushës së historisë nga Shqipëria dhe vende të ndryshme të Evropës dhe SHBA.

2. Prej tre vitesh, të gjithë artikujt shkencorë të paraqitur në redaksi, pas një shqyrtimi paraprak formal të tyre nga redaksia, i nënshtrohen procesit të recensionimit sipas parimit "double blind peer review", ku recensentët dhe autorët nuk njohin njëri-tjetrin.

3. Për pasqyrimin e mendimeve të recensentëve, nga vitii 2022 e në vijim është hartuar dhe operohet me formularin standard të recensës për artikujt shkencorë, cili u dërgohet rregullisht recensentëve për të pasqyruar mendimet në mënyrë sa më objektive.

4. Gjatë vitit 2023, u krijua faqja e re (homepage) e revistës "Studime historike", në

të cilën janë publikuar të gjithë shkrimet dhe numrat e revistave të botuara vitet e fundit si dhe synohet që në këtë faqe të publikohen të gjithë numrat e revistës që nga viti 1964, nga ku mund të shkarkohen materialet shkencore.


5. Nga numri 1, 2023, revista “Studime historike” krahas numrit të ISSN për versionin e saj të printuar, ka siguruar edhe numrin ISSN për versionin online.

6. Po ashtu, nga viti 2023 e në vijim, artikujt shkencorë të çdo autori përmbajnë numrin identifikues autentik (doi).

7. Artikujve shkencorë u janë shtuar disa rubrika si: abstrakti, fjalët kyçe, emërtimi i institucionit ku punon autori si dhe bibliografia.

www.akad.gov.al


Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë paraqiti numrin special “Studime filologjike, Bibliografi 1964-2024, me rastin e 60-vjetorit



Kryeredaktori i revistës akad. Valter Memisha, bëri një përshkrim historik të shkurtër të revistës në 60 vjet.

Pastaj e mori fjalën prof. dr. Anila Omari, sekretare shkencore aktuale e revistës. Ajo paraqiti një vështrim përmbledhës mbi revistën “Studime Filologjike”, duke filluar nga krijimi i saj në vitin 1964 si vazhdim i Buletinit shkencor të UT, seksioni i shkencave shoqërore; periodiciteti; administrimi shkencor me një redaksi ose bord editorial; struktura e përbërë me disa rubrika: artikuj shkencorë, probleme e diskutime, materiale e dokumente, kritikë e bibliografi, jeta shkencore; deri te përmbajtja e saj si revistë shkencore albanologjike, me profil gjuhësor e letrar, që u drejtohet veçanërisht specialistëve të këtyre fushave.

Prof. dr. Omari u ndal në fushën e studimeve gjuhësore në revistë, ku vendin kryesor e zënë botimet nga fusha e gjuhësisë sinkronike e diakronike. Artikujt përfaqësojnë studime nga të gjitha rrafshet e disiplinat gjuhësore: morfologji, sintaksë, fonetikë, dialektologji, leksikologji, leksikografi, semantikë, filologji, dhe kohët e fundit edhe gjuhësi e zbatuar, sociolinguistikë, analizë e diskursit e përkthimtari (tradukologji). Kontributi i personaliteteve të spikatur albanologjikë në vite dhe niveli i lartë shkencor që karakterizon pjesën më të madhe të artikujve, e bën revistën “Studime Filologjike” një nga revistat më të mira dhe më përfaqësuese, në hapësirën shqiptare e jashtë saj, në fushën e studimeve gjuhësore e letrare. Për shkak të kërkesave rigorozë ndaj autorëve të artikujve shkencorë, botimi në revistën “Studime Filologjike” ka qenë dhe mbetet një shkollë kualifikimi për studiuesit e rinj.



Më pas, zëvendëskryredaktorja e revistës prof. as. dr. Evalda Paci u ndal te studimet letrare, të orientuara për autorë e vepra të caktuara, për periudha letrare, për metodën studimit mbi tekstet letrare e çështje të konceptimit, për historinë e letërsisë shqiptare, te kritika letrare, te gjurmimet filologjike etj. që përfaqësojnë një linjë studimore të rëndësishme në historikun e revistës “Studime filologjike”.

Sipas saj, nga revista mund të veçohen artikuj që nisen nga premisa e analizimit të ndërthurjes së dimensioneve në modele të përveçme të krijimtarisë letrare, si në rastin e artikujve studimorë që përqendrohen në tipologjinë e tregimit apo të romanit bashkohor, si dhe sprovat që kanë pikënisje në qasje krahasimtare mes autorësh të

periudhave të afërta, apo të së njëjtës periudhë, por me krijimtari të lëvruar në areale të ndryshme. Vitet e fundit janë reflektuar kontributet studimore mbi autorë të cilët jetuan e lëvruan krijimtarinë e tyre periudha të ndryshme. Ka shkrime tematike për autorë të letërsisë shqipe të cilët realizuan pjesën më të madhe të veprimtarisë së tyre në vitet '30-40 të shekullit të kaluar e më tej që përbëjnë kontribute studimore origjinale.

Gjithashtu në vite janë botuar artikuj nga fusha e filologjisë së studimit të teksteve të vjetra shqipe, duke reflektuar studime tematike, recensione, analiza tekstore që kanë marrë shtysë nga botimet a ribotimet e veprave më të rëndësishme të letërsisë së mëhershme shqipe.



Letërsia arbëreshe ka gjetur një hapësirë të vetën në këta numra, duke u reflektuar në studime të përveçme, por dhe në materiale e dokumente të paraqitura dhe në konferenca shkencore të organizuara mbi autorë të rëndësishëm të saj.

Në fund prof. E. Paci nënvizoi se vend të veçantë në revistë kanë zënë dhe recensionet që kanë ardhur në një kohë të afërt me realizimin e botimeve kritike e filologjike të veprave të ndryshme por dhe të studimeve përkatëse.

Akad. Valter Memisha, në vazhdim të veprimtarisë promovuese, u ndal drejtpërdrejt te numri special i revistës, i cili është përgatitur nga doktorantja Engjëllushe Karaj. Përmes paraqitjeve pamore u dhanë të dhëna si më poshtë:

Botimi special “Studime filologjike” që u paraqit, jep pasqyrat e lëndëve të gjithë numrave të revistës duke filluar nga numri 1, dalë në vitit 1964 e duke përfunduar me

numrin e fundit 2, 2024. Në këta 60 vjet, revista ka njohur botim periodik, pa asnjë shkëputje dhe janë botuar gjithsej 171 numra: fillimisht me katër numra në vit për periudhën 1964-1990 (108 numra); me 3 numra në vitin 1991 (3 numra); me një numër në vitet 1992-1997 (6 numra); me dy numra në vit për periudhën nga viti 1998 deri më sot (54 numra).



Ky botim e jep lëndën 60-vjeçare:

- a. Të renditur kronologjikisht;
- b. Të renditur sipas fushave të studimit dhe rubrikave që përbëjnë strukturën e vetë revistës në vite (Studime gjuhësore, Studime letrare, Redaksionale, Folklor, Materiale dhe dokumente, Bibliografi, Recensione, Të ndryshme).
- c. Të renditur autorialisht, duke i grupuar titujt e artikujve etj., sipas autorëve, ndër të cilët veçojmë: E. Çabej, Dh. S. Shuteriqi, M. Domi, A. Xhuvani, A. Kostallari, Idriy Ajeti, Rexhep Qosja, J. Thomai, E. Lafe, K. Kodra, Sh. Demiraj, K. Topalli, Gj. Shkurtaj, Sh. Sinani, K. Bihiku, J. Bullo, E. Muhametaj, Th. Gjika, H. Shehu, M. Totoni, M. Samara, T. Osmani, R. Memushaj, S. Mansaku, M. Çeliku, Xh. Lloshi, J. Gjinari, Xh. Gosturani, B. Beci, B. Demiraj, F. Agalliu, F. Dado (Haxhiaj), K. Jorgaçi, E. Likaj, D. Luka, Sh. Islamaj, L. Buxheli, A. Omari, E. Paci, T. Plangarica, L. Smaçi, E. Kapia, A. Kananaj, A. Leka, L. Dauti, etj., apo studiues arbëreshë e albanologë të huaj, si Italo Kostante Fortino, Grigore Brancus, Idriz Ajeti, Eric P. Hamp, Gertruda Ejntrej, Norbert Jokl, Oreste Parise, Cătălina

Vătăşescu, Lucia Nadin, etj.

Botimi i numrit special të revistës “Studime filologjike”, në 60-vjetorin e saj tregon punën e madhe studimore shkencore të bërë në fushat e studimeve gjuhësore e ato letrare, nivelin e vetë revistës si institucion tashmë tepër i njohur dhe i referuar, por dhe do të ndihmojë e lehtësojë në mënyrë të ndjeshme punën shkencore, sepse e çon studiuesin apo të interesuarin drejtpërdrejt te bibliografia për lëndën që është botuar në vite në faqet e revistës.

www.akad.gov.al

U promovua libri “Ikonostaset e Shqipërisë” me bashkautorë Andrea Llukani - Ylli Drishti



Sot, më 23 dhjetor 2024, u promovua libri “Ikonostaset e Shqipërisë” me bashkautorë Andrea Llukani - Ylli Drishti, me mbështetjen e Komisionit të antropologjisë dhe trashëgimisë kulturore pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Veprimtaria u çel nga prof. Pirro Thomo, restaurator dhe studiues i njohur në fushën e arkitekturës bizantine dhe pasbizantine. Duke iu referuar materialeve të librit, ai prezantoi objektet e arteve të aplikuara në ikonostaset e kishave dhe manastireve, ku zbulohen të dhëna me rëndësi për autorët e këtyre veprave të artit. Prof. Thomo u përqendrua në të dhënat interesante të ikonave, duke i përshkruar këto vepra kudo që janë, që nga Manastiri i Ardenicës, në kishat e jugut të Shqipërisë, të juglindjes së Shqipërisë, e deri në kishat e Elbasanit.

Prof. Thomo foli edhe për historinë dhe peripecitë e personaliteteve të shquara të trashëgimisë për ruajtjen e këtyre veprave. Ai tha se libri është një nxitje që të depozitohen të gjitha ikonostaset ku janë e si janë, të inventarizohen dhe të vihen në dispozicion të Interpolit për të ndaluar trafikantët e këtyre veprave. Më tej, ai falënderoi autorët për punën e këtij vëllimi voluminoz me 328 faqe e 250 fotografi, vizatime e rikonstruksione hipotetike, të cilat do të vihen në shërbim të studiuesve të fushave dhe ruajtësve të

trashëgimisë.



Prof. Gazmend Leka tha se libri “Ikonostaset e Shqipërisë” i kushtohet gjuhës sonë arketipale, e cila buron nga kohërat e errëta kur perënditë thirrreshin me emrin e tyre të vërtetë, librat për historikun e flamurit tonë kombëtar, ku stampohet një shenjë e lashtë perandorake, e po ashtu librat për kodet e kanunet para ligjit, që rregullonin marrëdhëniet mes shqiptarësh, e shumë libra të tjerë që nuk i nxënë raftet e bibliotekave tona. Artisti i njohur Leka foli edhe për vlerat artistike. Ai theksoi ndër të tjera se kishat me ikonostas, ikonat dhe afresket shëmbëllojnë me një vepër të ilustruar të trashëgimisë, që është pasuria jonë e patundshme.

Z. Sokol Ismaili, drejtor i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore në Tiranë, përshëndeti autorët për punën e kryer. Ai vlerësoi faktin që autorët e librit kanë evidentuar edhe kohën kur u shkatërruan këto vepra dhe premti mbështetjen e vazhdueshme të IKTK-së për ruajtjen e veprave dhe vlerësimin e punës së gjithë studiuesve të fushës.

Në fund, autori Ylli Drishti foli për larminë kompozicionale dhe teknike të më se 48 ikonostaseve të studiuara dhe analizuara në këtë libër. Ai falënderoi të gjithë bashkëpunëtorët dhe specialistët që ndihmuan në realizimin dhe botimin e këtij libri dhe Akademinë e Shkencave të Shqipërisë që mbështeti promovimin dhe vuri në dispozicion sallën dhe specialistët e saj.

www.akad.gov.al

U promovua libri “Bujqësia biologjike”, një material me shumë rëndësi në formimin e specialistëve të bujqësisë, me autor Enver Isufin



Më 23 dhjetor 2024, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, u zhvillua promovimi i librit “Bujqësia biologjike” me autor Enver Isufin.

Kjo veprimtari u organizua nga Komisioni i biologjisë, bujqësisë dhe veterinarisë dhe Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.



Promovimi u drejtua nga prof. dr. Vjollca Ibro. Ajo e falënderoi autorin E. Isufi për

hartimin e këtij libri të domosdoshëm, në një kohë kur bujqësia biologjike ose organike është alternativa e duhur ndaj prodhimit konvencional. Prof. Ibro tha se ky libër është me shumë rëndësi edhe për formimin e specialistëve të bujqësisë.

Ajo ia dha fjalën Rektorit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, akad. asoc. Fatbardh Sallaku, i cili theksoi ndër të tjera se publikimi i librit "Bujqësia biologjike" është një kontribut për fokusin e veçantë në zhvillimin dhe zbatimin praktik të bujqësisë biologjike, duke paraqitur një analizë të thelluar mbi përvojat ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe praktikatat më të mira të zbatuara në Shqipëri.



Më pas, prof. dr. Endrit Kullaj e vlerësoi autorin e këtij libri për kontributin 30-vjeçar që ka dhënë në promovimin dhe zhvillimin e bujqësisë biologjike. Ai theksoi se Enver Isufi është figura më e shquar shqiptare në fushën e bujqësisë biologjike, ku ka dhënë një kontribut të madh në promovimin dhe zhvillimin e saj. Prof. Isufi ka botuar 12 libra profesionalë dhe qindra artikuj këshillues e dhjetëra artikuj shkencorë në sferën e mbrojtjes së bimëve dhe bujqësisë biologjike. Më tej, ai e vlerësoi autorin e librit për punën që ka bërë si drejtues i Institutit të Bujqësisë Biologjike, ku ka udhëhequr projekte të shumta kërkimore dhe ka ofruar këshilla praktike për fermerët dhe specialistët drejt metodave biologjike dhe miqësore me mjedisin.

Prof.dr. Endrit Kullaj e vlerësoi librin edhe për analizën gjithëpërfshirëse, dhe faktin që autori ndërthur shkencën me praktikën për të ndihmuar specialistët dhe fermerët që të menaxhojnë sfidat e mbrojtjes së bimëve, duke shmangur përdorimin e

pesticideve sintetike, dhe për strategjitë që lidhen me rritjen e tregut të produkteve biologjike shqiptare dhe rolin e certifikimit për të garantuar, cilësinë dhe përputhjen me standardet ndërkombëtare.



Marrëveshje bashkëpunimi

Marrëveshje bashkëpunimi midis Akademisë së Shkencave dhe Bashkisë Roskovec



Në datën 26 dhjetor 2024, në Bashkinë e Roskovecit, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi nga Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi dhe Kryetarja e Bashkisë Roskovec znj. Majlinda Bufi.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje konfirmon anëtarësimin me të drejta të plota të Bibliotekës Publike të Roskovecit në sistemin e përbashkët digjital [COBISS.AL](https://www.cobiss.al), që menaxhohet nga Qendra e Informacionit Shkencor (QKPISH) pranë ASHSH-së.

Kjo marrëveshje ka për qëllim zgjerimin e rrjetit të informacionit shkencor dhe akademik përmes bibliotekave dhe qendrave të informacionit në vend.

Në këtë takim bashkëpunimi morën pjesë drejtuesja e Qendrës së Informacionit (QKPISH) znj. Mirlona Buzo, drejtuesja e sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Publikun prof. asoc. Elda Zotaj, nënkryetari i Bashkisë së Roskovecit z.Maksim Goga dhe përgjegjësjja e Bibliotekës Publike të Roskovecit znj. Mimoza Hazizi.

Bashkia e Roskovecit mbështet dhe vlerëson nismën e Akademisë së Shkencave për sigurimin e aksesit të hapur në burime elektronike të informacionit për komunitetin e saj dhe më gjerë.

www.akad.gov.al

Mbledhje të komisioneve të përhershme të ASHSH

U zhvillua mbledhja e Komisionit të përhershëm të Gjuhësisë dhe të Letërsisë për projektin e strategjisë së kërkimit shkencor dhe planifikimin e aktiviteteve për vitin 2025



Më 13 dhjetor 2024, në Akademinë e Shkencave, u zhvillua mbledhja e Komisionit të përhershëm të gjuhësisë dhe të letërsisë, me pjesëmarrjen e anëtarëve të komisionit dhe grupit të punës për strategjinë e kërkimit shkencor të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Mbledhja u kryesua nga prof. dr. Anila Omari, kryetare e Komisionit të përhershëm të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Diskutimet u përqendruan në projektin e Strategjisë së kërkimit shkencor, e cila do të finalizohet në ditët në vijim, si dhe në planifikimin e aktiviteteve për vitin 2025. U diskutua nevoja e përditësimit të disa çështjeve të drejtshkrimit të gjuhës shqipe, pa prekur parimet themelore.

Ndër propozimet e miratuara ishin:

- Organizimi i një tryeze pune për drejtshkrimin nën drejtimin e akad. Kristina Jorgaqit, ku do të trajtohen çështje si përdorimi i shkronjës së madhe, shkrimi i emrave të përveçëm të huaj dhe fjalët e përbëra me vizë ose zanore lidhëse.
- Përfshirja e një grupi pune të specializuar për këto çështje, duke bashkëpunuar me gjuhëtarë nga Kosova.

Gjithashtu, u diskutua për mundësinë e organizimit të një veprimtarie ndërdisiplinore kushtuar Peter Priftit.

www.akad.gov.al

U zhvillua mbledhja e Komisionit të arteve për veprimtaritë dhe projektet e vitit 2025



Sot në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua mbledhja e Komisionit të arteve me praninë e zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole, prof. Arben Llozi, dr. Denis Bizhga, prof. Namik Dokle, dr. Belfjore Qose, znj. Abigela Voshtina, prof. dr. Enika Abazi, etj.

Mbledhja u drejtua nga akad. Vasil Tole.

Në këtë mbledhje u bënë diskutime dhe propozime për veprimtaritë e vitit 2025.

U diskutua mbi CNRS-në (Qendra Kombëtare e Kërkimeve Shkencore) dhe mundësitë e bashkëpunimit në fushat e shkencave humane dhe sociale.

Një pikë tjetër e kësaj mbledhjeje ishte diskutimi për vlerësimin me titullin “Nderi i Akademisë”.

Gjatë kësaj mbledhjeje u propozua që Komisioni i arteve të bashkëpunojë edhe me Akademinë e të Rinjve.

Gjithashtu, u bënë diskutime për portalet dhe CNRS-në (French National Centre for Scientific Research).

U diskutua prezantimi i një portali që përfshin fushat e antropologjisë, arkeologjisë, historisë, gjuhësisë, letërsisë, artit, ekonomisë, filozofisë dhe shkencave politike.

Më tej, u dhanë ide dhe u diskutua mundësia për krijimin e kontakteve dhe

identifikimin e bashkëpunimeve për projekte të përbashkëta dhe periudha studimore pranë qendrave kërkimore në Francë.



Për më shumë hollësi mbi portalin, mund të klikoni në linkun më poshtë:
CNRS Humanities and Social Sciences Research Portal
www.akad.gov.al

U zhvillua mbledhja e Komisionit të përhershëm të historisë

- U diskutua për projektin e Strategjisë së kërkimit shkencor të Institutit të Historisë dhe aktivitetet e vitit 2025-



Në datën 17 dhjetor 2024 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua mbledhja e Komisionit të përhershëm të historisë. Morën pjesë prof. Paskal Milo, kryetar i këtij komisioni, akad. Marenglen Verli, prof. Kaliopi Naska, prof. Bernard Zotaj, prof. Redion Luli, prof. Andi Rëmbeci, prof. Petrit Nathanaili, prof. Ferid Hudhri, prof. Ermal Baze dhe prof. Arben Cici.

Mbledhja u zhvillua për diskutimin e projektit të Strategjisë së kërkimit shkencor të Institutit të Historisë dhe aktivitetet e vitit 2025, si dhe për çështje të përfshirjes dhe bashkëpunimit në projekte shkencore.

Kryetari i komisionit prof. Paskal Milo theksoi rëndësinë e diskutimit të strategjisë dhe e konsideroi atë si një çështje të rëndësishme për zhvillimin e kërkimit shkencor.

Ai u shpreh se dokumenti duhet të njihet paraprakisht, që të finalizohet strategjia pas shqyrtimit në Këshillin Shkencor dhe më pas dokumenti të shpërndalet për shqyrtim, e në mbledhjen tjetër të komisionit të diskutohet. Mbledhja pritet të zhvillohet në periudhën 10-15 janar 2024.



Prof. Hamit Kaba i siguroi të pranishmit se po vijon puna që të vihen të gjithë në dijeni për projektin. Diskutimet për këtë projekt janë duke u zhvilluar dhe priten mendime konstruktive. Prof. Paskal Milo tha se ASHSH-ja do të miratojë një strategji të përbashkët për të gjitha institutet dhe mendimet e dhëna do të përmbliidhen në një dokument që do t'i dërgohet qeverisë. Si përfundim prof. Milo u shpreh se mendimet dhe propozimet duhet të reflektojnë vullnetin e shumicës.



Prof. Kaliopi Naska theksoi se materiali duhet të vijë i përfunduar në komision

dhe më pas të diskutohet.

Më pas u diskutua për aktivitetet që mund të përfshihen në planin e punës së Komisionit të historisë për vitin 2025, si konferenca dhe tryeza shkencore.

Prof. Ferid Hudhri propozoi një seminar për çështje të diskutueshme, jo vetëm nga këndvështrimi i historisë, por edhe të historiografisë, për të nxitur një mjedis intelektual historiografik.

Prof. Hamit Kaba e vuri theksin te nevoja për bashkëpunim dhe koordinim mes anëtarëve të komisionit dhe Institutit të Historisë për të përmirësuar marrëdhëniet dhe ndikimin në mjedisin shkencor.

Prof. Paskal Milo theksoi se është detyrë e çdo institucioni të bëjë propozime dhe ASHSH-ja do të mbështesë çdo iniciativë, por është e rëndësishme që aktivitetet të përfshijnë të gjithë pjesëmarrësit dhe të zbatojnë politikatat e gjithëpërfshirjes.

Prof. Marenglen Verli tha se, pas shqyrtimit të propozimeve, komisioni duhet të përzgjedhë aktivitetet, dhe ASHSH-ja duhet të angazhojë specialistë për aktivitete të caktuara. Ndërsa prof. Bernard Zotaj theksoi se ASHSH-ja, si një institucion shkencor, duhet të dalë me përfundime të qarta për ngjarje të caktuara në histori. Prof. Arben Cici trajtoi çështjen e lëndës së historisë në shkollat e mesme dhe propozoi organizimin e një tryeze për këtë temë.

www.akad.gov.al

U zhvillua mbledhja e Komisionit të përhershëm të ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike



Në datën 16 dhjetor 2023 u zhvillua mbledhja e Komisionit të përhershëm të ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike. Kjo mbledhje, në rend të ditës kishte ligjëratën e prof. Andi Kozhaj “Telepuna në Shqipëri” dhe diskutime e propozime për aktivitetet e vitit 2025.

Kryetari i komisionit, akad. Anastas Angjeli, vlerësoi temën e telepunës si një çështje mjaft aktuale dhe me rëndësi të veçantë në shumë dimensione. Ai tha se gjatë ligjëratës së tij, prof. Andrea Koxhaj dha një përkufizim të detajuar të telepunës, duke e dalluar nga puna e thjeshtë në distancë. Ai theksoi se telepuna, një formë pune që realizohet nëpërmjet teknologjive të komunikimit, kërkon një kuadër të qartë ligjor dhe investime në trajnimin e punonjësve. Sipas tij, përparimet teknologjike kanë krijuar mundësi të reja për realizimin e punës nga distanca, duke reduktuar kostot dhe duke rritur fleksibilitetin e organizatave.

Në vijim nga të pranishmit u paraqitën avantazhet dhe disavantazhet e telepunës. U theksua se kjo formë pune sjell fleksibilitet për punonjësit, duke përmirësuar balancën mes jetës personale dhe asaj profesionale dhe ul ndjeshëm kostot për kompanitë dhe individët. Në anën tjetër, sfidat përfshinin izolimin social, mungesën e kufijve të qartë

mes punës dhe jetës personale, si dhe vështirësitë teknologjike për ata që nuk kanë mjetet e duhura.



Në fund u arrit në konkluzionin se përmirësimi i kuadrit ligjor për telepunën është i domosdoshëm për të mbrojtur të drejtat e punonjësve, duke përfshirë të drejtën për t'u shkëputur nga puna pas përfundimit të orarit. Gjithashtu, u diskutua për rëndësinë e modelit hibrid të punës, i cili kombinon përfitimet e punës në zyrë dhe telepunës.

Në pjesën e dytë të mbledhjes, akad. Anastas Angjeli rikujtoi se deri më 27 dhjetor priten propozimet për planin e aktiviteteve shkencore për vitin 2025, duke përfshirë konferenca, workshop-e dhe tryeza shkencore. Diskutimet mbi këtë çështje u përqendruan në identifikimin e temave prioritare dhe në propozimin e aktiviteteve.

www.akad.gov.al

Takime pune

Takim pune për bashkëpunimin me kryetarët e bashkive të rretheve dhe drejtuesit e punonjësit e bibliotekave publike të përfshira në rrjetin COBISS.AL



-Zgjerimi i rrjetit të informacionit të bibliotekave publike në Shqipëri-

Sot më 6 dhjetor 2024 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua një takim pune me kryetarët e bashkive të rretheve, si dhe drejtuesit e punonjësit e bibliotekave publike të përfshira në rrjetin COBISS.AL.

Takimin e çeli dr.Mirlona Buzo, drejtuese e Qendrës për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor (QKPISH). Pasi u uroi mirëseardhjen të pranishmëve, ajo ia dha fjalën akad. Skënder Gjinushit, kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akad. Skënder Gjinushi falënderoi për bashkëpunimin e tanishëm në kuadër të statusit që merr Qendra për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor, me funksionet e një strukture rajonale, e cila vepron sipas marrëveshjes së nënshkruar me Institutin për Informacionin Shkencor (IZUM). Ai theksoi se Akademia e Shkencave po punon për konsolidimin e rrjetit të bibliotekave në Shqipëri, me synimin për të përhapur

informacionin digjital në mënyrë sa me efikase, me metodat me moderne dhe sipas standardeve të BE-së për të mundësuar aksesin e informacionit midis bibliotekave të këtij rrjeti për të gjithë përdoruesit.

Dr.Mirlona Buzo, drejtuese e QKPISH-it, paraqiti raportin për zgjerimin e rrjetit të informacionit digjital të bibliotekave në Shqipëri. Ajo tha se Akademia e Shkencave e Shqipërisë si një institucion i rëndësishëm për organizimin dhe drejtimin e veprimtarisë shkencore në vend në bashkëpunim me Institutin e Shkencave të Informacionit në Slloveni, duke vlerësuar rritjen e interesit për informacionin digjital në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare mundësuan krijimin e qendrës për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor.



Kjo qendër ka disa funksione por ne jemi në hapat e parë, që nisin me konsolidimin e platformave që zotërojmë dhe që shumica e bibliotekave publike i kanë tashmë në përdorim si baza për kërkuesit shkencorë ([Ecris.AI](#)) dhe katalogu i përbashkët [COBISS.AL](#), si edhe platformat për burimet online EIFL dhe Unpaywall.

Në këtë rrjet online janë përfshirë 40 biblioteka publike dhe universitare. 87 punonjës të këtyre bibliotekave janë kualifikuar dhe janë pajisur me licencat përkatëse për të punuar në këtë sistem. Këta punonjës prezantohen vazhdimisht me përditësimet e sistemit dhe platformave të reja për digjitalizimin e informacionit.



Më tej, dr. Buzo foli për bashkëpunim dhjetëvjeçar dhe arritjet falë këtij bashkëpunimi me drejtuesit dhe punonjësit e bibliotekave publike për ngritjen e rrjetit të përbashkët të digjitalizimit të informacionit COBISS.AL në Shqipëri, të cilët vlerësuan dhe punuan me përkushtim për automatizimin e proceseve të bibliotekës në ndihme të përdoruesve të tyre me gjithë vështirësitë që kanë hasur. Gjatë këtyre viteve për integrimin dhe përdorimin e këtij sistemi bibliotekat publike janë ndihmuar nga Instituti i Shkencave të Informacionit në Slloveni për pasurimin e fondit të librave me hyrje të reja, për infrastrukturën e rrjetit kompjuterik (kompjuterë dhe printerë), instalimin pa pagesë të programit dhe platformave digjitale, kualifikimin profesional të punonjësve të bibliotekave publike, pajisjen me manualët dhe standardet ndërkombëtare të digjitalizimit të informacionit.

Në fund, ajo tha se me krijimin e qendrës marrëdhëniet midis institucioneve bashkëpunuese për shërbimet e përmendura më sipër është e domosdoshme të formalizohen përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit midis ASHSH dhe bibliotekave publike.

www.akad.gov.al